



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 02-020-01-38424-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. _____

Data / Datum / Date 22. 12. 2025
OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilič - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 58 pika (h), neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 13 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës, të miratojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK TË LISTËS SË PËRGJITHSHME TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS DHE LISTËN E VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PËR VITIN VIJUES 2026

Neni 1

Sipas këtij propozim vendimi Komuna e Obiliqit publikon Listën e Veçantë të pronave komunale për vitin vijues 2026 të përgaditura dhe të verifikuara nga ana e Komisionit komunal për verifikimin e pronave komunale si dhe publikimin e pronave komunale në web – faqen zyrtare të komunës.

Neni 2

Për pronat komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim afatgjatë, gjatë vitit vijues komisioni ka përgaditur listen e veçantë e cila është pjesë e këtij propozim vendimi .

Neni 3

Periudha kohore për pronat e paluajtshme Komunale që do të jepen në shfrytëzim afatgjatë 15-99 vite .

Neni 4

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale është rritja e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës, zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër dhe Komisioni për verifikimin e pronave komunale.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës sipas autorizimeve të veta dhe me qëllim të realizimit të interesit publik rritjes së vlerës ekonomike të pronës së paluajtshme të komunës, krijimit të të hyrave vetanake në një anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës.

Këtij propozim vendimi i bashkangjitet :

- Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues.

Datë : 22.12.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Halil Thaçi

